

VENDIM
Nr. 556, datë 1.10.2025

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË FORUMIT TË INVESTIMEVE MIDIS
VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE VENDEVE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR, QË DO TË ZHVILLOHET NË TIRANË,
NË DATAT 13–14 TETOR 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, në zërin 603 “Subvencione”, të programit 01320 “Shërbime qeveritare”, i shtohet fondi prej 31 753 000 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Forumit të Investimeve midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13–14 tetor 2025.

2. Efekti financiar, prej 31 753 000 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama